

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-28/15-06

Prishtinë, më 13, 14 dhe 17 korrik 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 84 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lirinë fetare në Kosovë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat Nr. 2003/07,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardizim Nr. 2004/12,
8. Shqyrtimi i Raportit për punën 100 ditësh të Qeverisë së Kosovës,
9. Shqyrtimi i Raportit me rekomandimet e Kryesisë për Qendrën Administrativo – Protokollare në Gërmi,
10. Shqyrtimi i procedurave për emërimin e anëtarit të pestë në Këshillin e KPM,
11. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Kryetari i informoi deputetët për qëllimin dhe propozimin e rendit të ditës së kësaj seance.

1. Miratimi i rendit të ditës

Për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Gjylnaze Syla, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kërkoi që në seancën e radhës të radhiten për shqyrtim dy kërkesat e këtij grupi: a) Hartimi i Kushtetutës së Kosovës dhe b) Miratimi i Rezolutës për organizimin e diasporës kosovare.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi që debati për raportin 100 ditësh të Qeverisë së Kosovës të mos kufizohet në dy orë, por të jetë debat i hapur që ia mundëson çdo deputeti të diskutojë për këtë pikë, në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi të procedohet me rendin e ditës së kësaj seance, siç e kishte propozuar Kryesia në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare.

Nazim Jashari, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, kërkoi që debati për pikën e tetë të mos kufizohet, por të gjithë deputetët të gëzojnë të drejtën për të diskutuar në përputhje me rregullën 22.7 të Rregullores së Punës të Kuvendit.

Sabit Rrahmani, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim tha se i mbështet kërkesat e grupeve parlamentare të PDK-së dhe të ORA-s.

Naim Maloku e sqaroi propozimin e Kryesisë, me të cilin ishin pajuar edhe kryetarët e grupeve parlamentare, që debati për raportin e Qeverisë së Kosovës për punën 100 ditësh të kufizohet në dy orë dhe koha e diskutimeve të jetë, për secilin grup parlamentar, në përputhje me vendet që kanë në Kuvend.

Hajredin Kuçi kërkoi të votohet për propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kryetari i hodhi në votim kërkesat e grupeve parlamentare të PDK-së dhe të ORA-s. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----42;
Kundër----- 47;
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi nuk i miratoi kërkesat e grupeve parlamentare të PDK-së dhe të ORA-s. Kuvendi i vazhdon punimet me rendin e ditës të propozuar nga Kryesia në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare.

Deputetët e grupeve parlamentare të PDK-së, të ORA-s dhe për Integrim, në shenjë pakënaqësie, e lëshuan seancën.

2. Miratimi i procesverbali të seancës plenare të 29 qershorit 2006

Procesverbali i seancës plenare të 15 qershorit 2006 u miratua pa vërejtje.

Deputetja **Gjylnaze Sylja** pati vërejtje në transkript, ngase nuk ishte përfshirë diskutimi i saj.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Ramadan Kelmendi** pyeti kryeministrin Agim Çeku: Çka ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës për t'ia njohur stazhin e punës punëtorëve të larguar dhunshëm nga puna në periudhën 30.8.1990 deri më 30.6.1999? si dhe pyetjen e dytë- Çka ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës për nxjerrjen e librezave të punës për të punësuarit?

Ministri i Punës dhe i Çështjeve sociale, **Ibrahim Selmanaj**, iu përgjigj deputetit Kelmendi për pyetjet e parashtruara.

Deputeti **Emrush Xhemajli** pyeti ministrin e Rendit, z. Fatmir Rexhepi - Kush e ka urdhëruar SHPK-në që të intervenojë kundër protestuesve në Merdare dhe në Mitrovicë?

Ministri **Fatmir Rexhepi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Emrush Xhemajli** pyet ministrin e Drejtësisë, z. Jonuz Salihaj: -Me cilin ligj mbrohet Serbia në Kosovë?

Ministri **Jonuz Salihaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Alush Gashi** pyeti ministrin e Punëve të Brendshme lidhur me përgatitjet për formimin e Shërbimit të Zbulimit dhe të Kundërzbulimit.

Ministri **Fatmir Rexhepi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Gashi.

Deputeti **Alush Gashi** pyeti ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me mbrojtjen e liqenit të Batllavës nga ujërat e zeza.

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetit Gashi

Deputeti **Alush Gashi** pyeti ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me veprimet e kësaj Ministrie për zhdukjen e analfabetizmit dhe të dhunës fizike në shkollë.

Ministri **Agim Veliu** iu përgjigj pyetjes së deputetit Gashi.

Deputeti **Alush Gashi** pyeti ministrin e Ekonomisë dhe Financave lidhur me përgatitjen e Projektbuxhetit për vitin 2007.

Ministri **Haki Shatri** iu përgjigj pyetjes së deputetit Gashi.

Deputeti **Alush Gashi** pyeti kryeministrin e Kosovës lidhur me angazhimin e dy këshilltarëve nga Kuvendi i Kroacisë.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Alush Gashi.

Kryetari dha pauzë.

Pas pauzës, **kryetari** tha se gjatë konsultimeve që kishte pasur me kryetarët e grupeve parlamentare lidhur me pikën e tetë e kanë lënë ta shqyrtohet edhe njëherë kur t'i vijë radha.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lirinë fetare në Kosovë

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1a, 2a, 3, 4, 5, 6a, 7, 8, 9, 10a, 11a, 12a, 13, 14, 15, 16, 17a, 18, 19, 20, 21, 22a, 23, 24, 25a, 26, 27 dhe 28.

Pastaj kryetari e hodhi në votim Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----57;

Kundër----- 5.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për lirinë fetare në Kosovë.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Çështje Sociale.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21.

Pastaj kryetari e hodhi në votim Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----58;

Kundër----- 3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat Nr. 2003/07

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai e hodhi në votë rekomandimin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, rini dhe Sport.

Kuvendi me shumicë votash miratoi amendamentin 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat Nr. 2003/07

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardizim Nr. 2004/12

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurën e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardizim Nr. 2004/12.

8. Shqyrtimi i procedurës për emërimin e anëtarit të pestë në Këshillin e KPM

Kryetari e hodhi në votim propozimin e procedurës për emërimin e anëtarit të pestë në Këshillin e KPM.

Rezultati i votimit ishte si vijon;

Për-----57;

Kundër----- 3.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash miratoi procedurën për emërimin e anëtarit të pestë në Këshillin e KPM.

E premte, 14 korrik 2006

Vazhdim i sëancës

9. Shqyrtimi i Raportit për punën 100 ditësh të Qeverisë së Kosovës

Kryetari i informoi deputetët për marrëveshjen e Kryesisë dhe të kryetarëve të grupeve parlamentare që koha e diskutimit për këtë pikë të zgjasë për secilin deputetë deri në dhjetë minuta.

Ai e ftoi kryeministrin e Kosovës ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit raportin për punën 100 ditësh të Qeverisë së Kosovës.

Kryeministri **Agim Çeku** paraqiti një përmbledhje të punës së Qeverisë së Kosovës për punën 100 ditësh.

Platforma e Qeverisë prej tri “E”-ve përmban strategjitë tonë kryesore. E- është agjenda për integrim. “E” energjetikën dhe “E” – edukimin. Qeveria gjatë kësaj periudhe të shkurtër ka bërë disa hapa të rëndësishëm në funksion të kësaj platforme.

Në fushën e energjisë, Ministria e Energjisë dhe Minierave, së bashku me UNMIK-n arritën një marrëveshje me Bankën Botërore për të tërhequr kapitalin e jashtëm privat në sektorin e energjisë në Kosovë. Rezultat i menjëhershëm i kësaj marrëveshjeje ka qenë një donacion prej 8.5 milion € dhe hapja e Zyrës së projektit drejtues për termocentralin Kosova C. Kjo marrëveshje, si dhe miratimi i strategjisë për energji, paraqet një zhvillim të rëndësishëm për resurset minerale të Kosovës dhe kapacitetet gjeneruese të energjisë si dhe tregon dhe ka një të ardhme me shumë mundësi për rritje ekonomike.

Në fushën e edukimit, Qeveria ka vazhduar aktivitetet e rregullta në procesin e formave në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet arsimore. Aktiviteti parësor ka qenë i përqendruar në rivendosjen e ligjshmërisë dhe në reformën e Universitetit të Prishtinës. Për këtë qëllim janë miratuar udhëzimet dhe vendimet përkatëse administrative të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë dhe të Qeverisë, që e ka përkrahur zhvillimin e zgjedhjeve të lira në Universitetin e Prishtinës, konstituimin e organeve drejtuese të Senatit dhe Këshillit Drejtues, si dhe zgjedhjen e rektorit.

Qeveria gjatë kësaj periudhe ka arritur objektivin e përmbushjes së kriterëve për **afrim me Bashkimin Evropian**. Gjatë kësaj kohe është përpiluar **plani i -veprimit për partneritet evropian**, është harmonizuar legjislacioni kosovar me atë evropian dhe është punuar në ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e agjendës evropiane.

Qeveria ka themeluar Agjencinë për Integritet Evropian dhe ka ndërmarrë nismën për hapjen e Zyrës Ndërlidhëse në Bruksel. Është mbajtur një takim i mekanizmit përcjellës të stabilizim- asocimit dhe tjetri është duke u mbajtur sot.

Pastaj **kryeministri** paraqiti më hollësisht punën e secilës ministri për këtë periudhë kohore.

Në fushën e ekonomisë dhe të financave janë shënuar këto të arritura: Janë finalizuar dokumentet bazike lidhur me programin e investimeve publike dhe kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2007-2009. Janë rritur të hyrat e mbledhura brenda në vend si rezultat i ngritjes së shkallës së deklarimit nga ana e tatimpaguesve, si dhe rritjes së kontrollit prej ATK-së.

Realizimi i shpenzimeve është sipas nivelit të paraparë me Ligjin e buxhetit dhe projeksionet tona deri në fund të vitit janë që do të realizohet afërsisht sipas planit. Krahasuar më vitin e kaluar vërehet se në shumicën e kategorive kemi ulje të shpenzimeve.

Në fushën e industrisë dhe turizmit është finalizuar projekti i Bankës Botërore i quajtur BETA. Kanë vazhduar punimet e infrastrukturës së parkut industrial në Drenas, është realizuar projekti i Inkubatorit të biznesit në Deçan dhe Gjilan, në bashkëpunim me Agjencinë Evropiane të Rindërtimit dhe është në përfundim edhe projekti në Shtime.

Krijimi i uan stop shopeve (qendrave lokale të biznesit). Këto qendra do të jenë stacioni i parë dhe më i afërt i bizneseve nëpërmjet të cilave do të lehtësohen të gjitha procedurat për biznese.

Është përfunduar faza e pilot-projektit të skemës së këshillimeve dhe trajnimeve.

Gjatë kësaj periudhe , janë mbajtur tri rundet e privatizimit, ku janë privatizuar gjithsej 57 ndërmarrje shoqërore.

Në fushën e energjisë dhe të minierave është përgatitur Projektligji për hulumtime gjeologjike në Kosovë. Është themeluar Instituti Sizmologjik i Kosovës. Ka filluar hartimi i strategjisë për zhvillimin e sektorit të xehetarisë, faza përgatitore është kryer. Është përgatitur dokumenti: -Strategjia e Kosovës për ristrukturimin e Trepçës.

Në fushën e arsimit, Ministria e Arsimit ka vazhduar aktivitetet të rregullt në procesin e reformave në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet arsimore, sipas politikave zhvillimore të parapara në strategjinë zhvillimore të arsimit të Kosovës 2002/2007.

Në Departamentin e Arsimit Para Universitar janë realizuar të gjitha aktivitetet e parapara me planin e punës. Në arsimin e lartë aktiviteti kryesor ka qenë përqendruar në Universitet. Ka filluar zbatimi i projektit të OSBE-së për avancimin e proceseve të planifikimit, menaxhimit dhe të raportimit të financave në Universitetin e Prishtinës .

Në fushën e bujqësisë, të pylltarisë dhe të zhvillimit rural është përgatitur Projekti për themelimin e Fondit për zhvillimin rural, i cili do të sigurojë grante plotësuese për fermerët , si dhe për ndërmarrjet rurale. Janë marrë të gjitha masat për parandalimin dhe evitimin e gripit të shpendëve. Është themeluar Enti i Verërave. Është nënshkruar memorandumi me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Është bërë licencimi i 45 ordinancave private,qëkryesisht merren me preventivat, shërimin e sëmundjeve dhe përmirësimin e shëndetit të kafshëve etj.

Në fushën e kulturës,të rinisë dhe të sportit, ka filluar implementimi i fushatës me moton “**Ruaje- është jotja**”, për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë. Është nënshkruar marrëveshja me Bankën Botërore për ndihmë në sektorin e rinisë me vlerë për 2 milion dollarësh për tri vjetët e ardhshëm

Kanë filluar punimet restauruese , konservuese në tri tërësi: në:katedralen e Shën Xhorxhit” në Prizren, në kishën e Shën Nikollës ’në Prishtinë dhe në manastirin e Deviçit.. Është themeluar Qendra Kinematografike dhe sipas Ligjit për kinematografinë, Ministria e ka bërë zgjedhjen e drejtorit dhe e ka filluar organizimin administrativ të këtij institucioni.

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të planifikimit hapësinor është hartuar Ligji për vlerësimin strategjik të mbrojtjes së mjedisit dhe është bërë amendamentimi i Ligjit për mbrojtjen e mjedisit. Ka përfunduar diskutimi publik i planit hapësinor të Kosovës. Është përgatitur Propozim- udhëzimi për kushtet e përkohshme të rregullimit të zonës së Prevallës në Parkun Nacional malet e Sharrit. Është hartuar Ligji për parqet nacionale dhe Ligji për zhurmën. Janë inauguruar dy objekte të reja për banorët e kampit të Plemetinit , si dhe janë siguruar mjetet e nevojshme për mbylljen e tërësishme të këtij kampi.

Në fushën e shëndetësisë, Ministria është përqendruar në përpilimin e strategjive për avancimin e shëndetësisë në Kosovë, formulimin e legjisllacionit përkatës , posaçërisht të spitaleve rajonale dhe të Qendrës Klinike Universitare.

Është themeluar Bordi për licencimin e institucioneve shëndetësore private. Është themeluar Inspektorati Shëndetësor dhe ka filluar punën. Është hartuar strategjia për parandalimin e gripit. Janë bërë përgatitje të nevojshme për mbikëqyrjen e sëmundjeve të veçanta të etheve hemorragjike.

Në fushën e shërbimeve publike ka përfunduar faza e parë e hartimit të strategjisë për reformën e administratës publike. Janë bërë përgatitjet intensive për mbajtjen e regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave. Është hartuar Udhëzimi administrativ për unifikimin, organizimin e koeficienteve të pagave në Shërbimin Civil të Kosovës. Është finalizuar Projektligji për shndërrimin e poseduesve në pronarë. Në kuadër të planit të Institutit Kosovar për Administratën Publike (IKAP), për periudhën mars- maj 2006, janë kryer 23 programe trajnimi me 852 pjesëmarrës dhe me 224 ditë trajnimi në shtatë fusha.

Në fushën e pushtetit lokal është mbikëqyrur në mënyrë të vazhdueshme puna e kuvendeve komunale në zbatimin e ligjshmërisë. Ka filluar edhe identifikimi i ligjeve që prekin kompetencat e komunave dhe është bërë përgatitja e doracakut të ligjeve për t'i ndihmuar komunat në njohjen dhe zbatimin e ligjeve, që lidhen me pushtetin lokal. Janë ndihmuar pilot- njësitë komunale në procesin e hartimit dhe të miratimit të statusit të tyre.

Në fushën e kthimit, në fokus të Ministrisë së Kthimit ka qenë edhe realizimi i programit të vetëdijesimit për kthimin e qëndrueshëm dhe inkuadrimi i pakicave në institucionet e Kosovës. Ka filluar projekti i ndërtimit të 86 shtëpive në fshatin Babush të Ferizajt. Fillimi i projektit në fshatin Klinavc të Klinës për ndërtimin e 26 shtëpive, fillimi i ndërtimit të 28 shtëpive në komunën e Leposaviqit.

Në fushën e politikave sociale ka vazhduar puna në vendosjen e standardeve të duhura për shërbimet dhe mbrojtjen sociale, mbështetjen e gjerë dhe të qëndrueshme financiare të qytetarëve me nevojë, duke u zbatuar kriteret e ligjshme dhe transparente për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Një kujdes i veçantë është duke u treguar për fëmijët e braktisur dhe pa kujdes prindëror. Është punuar në mbrojtjen e fëmijëve me sjellje asociale dhe delinkuentëve të mitur. Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, me UNDP-, në projekt programin projekt për gjenerimin e punësimit, është duke u realizuar punësimi afatgjatë i punëkërkesve.

Në fushën e sigurisë janë bërë disa hapa të rëndësishëm. Janë themeluar: Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe ka filluar kalimi gradual i kompetencave në këto ministri. Është intensifikuar puna në procesin e rishikimit të Sektorit të sigurisë që do të rezultojë me përcaktimin e sistemit nacional të sigurisë në Kosovë. Në këtë kuadër ka filluar puna edhe për krijimin e Shërbimit Inteligent të Kosovës.

Është themeluar Këshilli për Siguri të Komuniteteve, që është paraardhës i Këshillit Kombëtar të Sigurisë.

SHPK-ja gjatë kësaj periudhe ka vazhduar me kontinuitet aftësimin dhe zhvillimin profesional.

Trupat e Mbrojtjes së Kosovës me sukses kanë vazhduar zhvillimin, aftësimin dhe profesionalizimin e mëtutjeshëm.

Qeveria llogarit në përkrahje të Kuvendit të Kosovës, UNMIK-ut dhe të shoqërisë civile, për ruajtjen e stabilitetit politik dhe institucional.

Kryetari e hapi debatin parlamentar lidhur me raportin për punën 100 ditësh të Qeverisë së Kosovës.

Alush Gashi tha se Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet Raportin për punën e Qeverisë dhe kërkon angazhim të shtuar për realizimin e programit.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamenta të PDK-së, tha se Raporti për punën e 100 ditësh të Qeverisë ngërthen të gjithë punën që është bërë gjatë këtyre shtatë vjetve të administrimit të pasluftës në Kosovë.

Kryeministri nuk tregoi se cilat kanë qenë detyrat që ua ka dhënë ministrave të Kabinetit të tij dhe nuk tregoi se çka është realizuar nga ato detyra.

të dhëna, nëse vërtetë ka pasur detyra. Ky do të ishte raporti 100 ditor i këtij kabinetit Në raport nuk thuhet as edhe një fjalë për politikën ekonomike të Kryeministrit të ri, çka ka bërë gjatë kësaj kohe për të stimuluar prodhuesit vendor.

Çka ka bërë për të zbutur papunësinë, për të nderprerë diferencimin në Shërbimin Civil, për të depolitizuar e reformuar arsimin. Sa ka ndryshuar punën e Këshillit për emërime të Larta?

Ministria e SHP ka përjashtuar nga puna mbi 95% të shërbyesve civilë në pozita të nivelit të lartë, përfshirë edhe sekretarin e përhershëm.

Çka ka bërë Qeveria në eliminimin e tri sistemeve të drejtësisë apo çka ka ndermend të bëjë? Çka ka bërë kryeministri për shpërbërjen e strukturave paralele në; siguri, gjyqësi, arsim e shëndetësi? Nuk e kemi as edhe një fjalë.

Në raport tri herë flitet për privatizimin, njëherë kryeministri ia mvësh suksesin vetës, kështu bëjnë edhe dy ministra të tjerë. Ky proces edhe pse ka defekte të shumëta, është i AKM-së e jo i Qeverisë.

Procesin negociator Qeveria ia mvësh vetës, e tërë bota e di se ky proces është duke u udhëhequr nga Grupi i Unitetit. Aty është hisja e institucioneve të tjera, por nuk mungon as hisja e opozitës.

Shpresojmë se në të ardhmen Qeveria do të dijë ta hartojë një raport pune, në bazë të programit të saj, që e ka miratua Kuvendi.

Gjylnaze Sylja tha se Grupi Parlamentar i AAK-së vlerëson se raporti për punë 100 ditësh është inkurajues me trende pozitive dhe i përgëzon kryeministrin dhe ministrat e Qeverisë të Kosovës për punën dhe seriozitetin e treguar në angazhimet e tyre.

Pas qeverisjes 100 ditësh të Qeverisë Çeku lirisht mund të nxjerrim një bilanc të padiskutueshëm pozitiv, ngase treguesit evidencojnë rritjen e stabilitetit në fushën politike- ekonomike dhe të sigurisë.

Në vazhdim deputetja Gjylnaze Sylja paraqiti në hollësi të arriturat e Qeverisë gjatë 100 ditëshit , si dhe prioritet për punën e Qeverisë për periudhën vijuese.

Veton Surroi, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, tha se është dashur të kemi një raport 600- ditor të Qeverisë, ngase Qeveria nuk ka ndryshuar thellësisht, kanë ndryshuar vetëm kryeministrat.

Mund të thuhet që ndoshta ka ndryshuar mënyra e qeverisjes, e kjo është më shumë çështje e stilit se sa e substancës, por në thelb kemi një formë qeverisjeje e cila që nga dita e parë e saj është karakterizuar me esencën improvizues.

Qeverisja pa koncept është qeverisje që mbështetet në imputet politike në menaxhimin politik.

Raporti megjithatë kishte shumë të arritura dhe një raport i tillë tregon për një gjendje të mrekullueshme të qeverisjes në Kosovë, por për fat të keq realiteti i demanton raportet, realiteti është krejt tjetër prej atij realitetit të qytetarëve tonë ,është krejt tjetër prej asaj se çka dëgjojnë në raport.

Ajo çka ndoshta do të duhej përmendur në këtë raport është se Kosova nuk ka kryeministër. Kryeministri Çeku nuk ka të drejtë t'i ndërrojë ministrat e vet, sepse këtë nuk do t'ia lejonte koalicioni qeverisës.

Në vazhdim z.Surroi vlerësoi punën e Qeverisë të pasuksesshme në fushëat ekonomike, të sundimit të ligjit, të papunësisë, të arsimit, të shëndetësisë, të shërbimeve publike, si dhe për qytetin e Mitrovicës.

Mahir Jaghillar në emër të Grupit Parlamentar 6+, tha se gjatë këtyre 100 ditëve është krijuar stabilitet dhe janë bërë hapa të rëndësishëm për realizimin e standardeve dhe vlerësim pozitiv nga ana e Këshillit të Sigurimit dhe faktorëve të tjerë relevantë ndërkombëtarë.

Ka mjaft hapa pozitiv dhe të suksesshëm, veçanërisht nga aspekti i komuniteteve pakicë siç janë: botimi librave në gjuhën turke, procesi i arsimimit në gjuhën turke, botimi i Gazetës Zyrtare në gjuhën turke, përkrahja e institucioneve kulturore dhe shoqatave etj. Por, ka edhe lëshime në punën e Qeverisë, siç janë: mospjesëmarrja e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në punën e grupeve për hartimin e ligjeve. Shumë herë si partnerë të koalicionit nuk jemi këshilluar ose nuk kemi pasur qasje dhe pjesëmarrje në ngjarjet e rëndësishme për Kosovën.

Në parim e përkrahim raportin, por me shpresë që në të ardhmen do të kemi qasje më të mëdha të gjitha bashkësitë.

Sabit Rrahmani tha se Grupi Parlamentar për Integrim ka iniciativë që të forcohet pozita e minoriteteve në institucionet e Kosovës.

Z. kryeministër, keni pasur një vullnet mjaft të bujshëm që të punoni në interesin e komuniteteve. Ne ju urojmë për punën që keni bërë deri më tash.

Ka pasur edhe ngecje në implementimin e standardeve për pakicat. Ne shpresojmë që ju do të insistoni edhe më tepër që pozita e minoriteteve të jetë sa më pozitive në këtë drejtim.

Pakicat e tjera në krahasim me komunitetin serb janë kryesisht të anashkaluara. Pakicat e tjera e kanë dhënë provimin para jush: janë përfshirë në institucione e Kosovës, Ju përkrahin për pavarësinë e Kosovës, por serbët edhe pse e kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës, nuk marrin pjesë në institucionet e Kosovës, prapë më së shumti i përkrahni ata se neve.

Në vazhdim z. Rrahmani paraqiti gjendjen e vështirë për pjesëtarët e komunitetit ashkali, posaçërisht për ata që po kthehen nga shtetet e Perëndimit, si dhe pati vërejtje për punën e ministrit për Kthim dhe Komunitete.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për raportin e punës 100 ditësh të Qeverisë së Kosovës dhanë edhe këta deputetë: **Bajram Rexhepi, Afrim Arzallxhiu, Ramadan Kelmendi, Fehmi Mujota, Genc Gorani, Ibush Jonuzi, Nexhat Rexha, Ramë Buja, Safete Hadërgjonaj, Berat Luzha, Fetah Berisha, Bajrush Xhemajli, Jonuz Kastrati, Selvije Halimi, Ferid Agani, Sanije Aliaj, Zahrije Isufi, Hajredin Kuçi, Zylfije Hundozi, Gazmend Muhaxheri, Ragip Zekolli, Fatmire Mulhaxha, Gjergj Dedaj, Enver Hoxhaj, Xhevdet Neziraj, Xhavit Haliti, Behxhet Brajshori, Xhevat Bislimi, Sabri Hamiti, Nazim Jashari, Mazllun Kumnova, Teuta Sahatqija, Zef Morina, Flora Brovina, Xhelal Canziba, Nimon Alimusaj, Hatixhe Hoxha, Mark Krasniqi dhe Ymer Halimi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, kryeministri **Agim Çeku** i falënderoi deputetët e Kuvendit për vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna për punën 100 ditësh të Qeverisë së Kosovës, të cilat, shtoi ai, do t'i marrë parasysh për punën e ardhshme të Qeverisë.

E hënë, 17 korrik 2006
Vazhdim i seancës

Në seancë ishin të pranishëm 76 deputetë.

Në fillim seancën e kryesoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë, kurse pjesën e dytë e kryetari i Kuvendit, **Kolë BERISHA**.

10. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryesuesi i informoi deputetët për propozimin e Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit të dy (2) kandidatëve për postin e drejtorit të Agjencisë: Hasan Preteni dhe Ruzhdi Sefa.

Ai i njoftoi të pranishmit për mënyrën e votimit dhe kërkoi nga grupet parlamentare të propozojnë nga një vëzhgues për procesin zgjedhor të drejtorit të Agjencisë.

Komisioni zgjedhor e përbënin tre zyrtar të Departamentit Ligjor: Dëfrim Krasniqi, Natasha Prica dhe Xheladin Hoxha.

Vëzhguesit nga grupet parlamentare ishin: Naim Jerliu(LDK), Selviqe Halimi (PDK), Mazllun Kumnova (AAK), Genc Gorani (ORA), Sabit Rrahmani (Për Integrim) dhe Husnija Beshkoviq (6+).

Kryesuesi i ftoi , dy nga dy, deputetët e Kuvendit të votonin për drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit .

Pas numërimit të votave nga Komisioni Zgjedhor, nën vëzhgimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, kryesuesi e kumtoi rezultatin e votimit si vijon:

- 1.Hasan Preteni----- 57 vota;
2. Ruzhdi Sefa ----- 21 vota;
- Abstenime ----- 5 veta.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

1. Z. Hasan Preteni emërohet drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit.
2. Mandati i drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit zgjat pesë (5) vjet.

11. Shqyrtimi i Raportit të Kryesisë për Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi

Kryetari i informoi deputetët se në seancën plenare më 14 shkurt 2004 ishte shqyrtuar çështja e ndërtimit të Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi dhe kishte nxjerr përfundim, me të cilin ngarkohej Kryesia e Kuvendit ta shqyrtojë këtë çështje dhe kuvendit t'i paraqes raport lidhur me të.

Ai e ftoi Naim Malokun që në emër të Kryesisë të paraqes raportin para deputetëve.

Naim Maloku - Kryesia e Kuvendit gjatë shqyrtimit të materialeve lidhur me ndërtimin e Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi ka përgatitur një raport me rekomandime, i cili ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë është çështja procedurale që ka të bëjë me rezultatin e auditimit të jashtëm të Kuvendit të Kosovës dhe nuk mund t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Pjesa e dytë, në të cilën është përqendruar Kryesia e Kuvendit është çka të bëjmë me pronën dhe çka me objektin në fjalë dhe ka konstatuar si vijon: Objekti është pronë e Kuvendit të Kosovës, mjetet e shpenzuara deri më tani janë projekti 98.500 €, punë kryerësit u kanë paguar deri më tani nga buxheti i Kuvendit 1.651.832 €, për mbikëqyrjen e projektit dhe realizimin e punimeve deri më tani janë paguar 23.000€ nga 45.000 sa është kontrata me Regallin ,që është edhe kontrata mbikëqyrëse e mbikëqyrësit dhe realizimit të Projektit.

Gjithsej janë shpenzuar. deri më tani, 1.773.332 €. Mjetet e siguruara nga buxheti i këtij viti që ka kaluar në Kuvend janë rreth 1.600.00€ ,të cilat janë ende të pashfrytëzuara dhe nëse nuk shpenzohen së paku një pjesë gjatë këtij muaji ,ato mjete mund të kthehen dhe duhet t'i kthehen Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Kryesia i ka shqyrtuar 4 variante të mundshme se si të vepohet me objektin

Varianti i parë: Të vazhdohet me ndërtimin e objektit, kurse mbikëqyrësi i punimeve të jetë nën kontrollin e Divizionit Teknik të Kuvendit.

Për të realizuar këtë variant duhet të kryhen disa punë përgatitore: Të verifikohen punët e kryera se a janë adekuate me pagesat e bëra, të fillojë shpenzimi i mjeteve të dedikuara nga buxheti i këtij viti, të bëhet aneks -kontrata me vlerë të saktë të kostos së aneksit "C", të sigurohen mjetet në buxhetin e vitit të ardhshëm dhe mundësia e marrëveshjes edhe me Qeverinë për participim, në mënyrë që të shfrytëzohen objekti, pasi të ndërtohet.

Varianti i dytë:- Të ndërpriten punimet.

Varianti i tretë:- Shitja e objektit në këtë gjendje. dhe

Variantin e katërt: Demolimi i objektit dhe kthimi i hapësirës në gjendjen e mëparshme.

Duke i shqyrtuar të gjitha këto variante, secilën veç e veç, me të mirat dhe pasojat që i bartë secili variant, Kryesia e Kuvendit me shumicë t votash ka vendosur t'ia praqes Kuvendit raportin me rekomandime për miratim.

Pas këtij arsytimi, kryetari e hapi debatin lidhur me raportin e Kryesisë për Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me raportin e Kryesisë dhanë këta deputetë: **Alush Gashi, Jakup Krasniqi, Gazmend Muhaxheri, Ramë Buja, Xhezair Murati, Hydajet Hysen, Naser Osmani, Gjylnaze Syla, Nazim Jashari, Besa Gaxheri, Safete Hadërgjonaj, Lulzim Zeneli, Bajram Rexhepi, Selvije Halimi, Sanije Zeqiri, Ramadan Kelmendi, Xhevat Bislimi, Fadil Geci, Fetah Berisha, Berat Luzha, Ymer Muhaxheri, Gjylshene Berisha, Fatmire Mulhaxhe, Teutë Hadri dhe Sabri Hamiti**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim raportin e Kryesisë për Qendrën Administrativo – Protokollare në Gërmi. Rezultati i votimit ishte si vijon;

Për-----52;
Kundër----- 18
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

1. Vazhdohet me punimet për ndërtimin e Qendrës Administrative Protokollare në Gërmi.
2. Të bëhet ekspertiza për punët e deritanishme dhe për pagesat e kryera, si dhe për kërkesën e punë kryesit për mjete shtesë 34% për aneksin C.
3. Mbikëqyrësi i punimeve të jetë nën mbikëqyrjen e Divizionit Teknik të Kuvendit.
4. Parregullsitë eventuale në realizimin e këtij projekti mbetën çështje të auditimit dhe të organeve përkatëse për zbatimin e ligjit.

Shënim: Pjesë përbërëse e këtij procesverbali është transkripti nga kjo seancë.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 13:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Sektori për Çështje Plenare dhe Procedurale